

LIGJ
Nr. 111/2024

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9693, DATË 19.3.2007,
“PËR FONDIN KULLOSOR”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 10 pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Në rastet kur në fondin kullor publik dhe privat janë miratuar vendimmarrje të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit për zhvillime turistike, nuk ndiqet procedura e heqjes nga fondi kullor, por struktura e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave bashkiake, pasi merr dijeni, bën azhurnimin kadastral në kadastrën e fondit kullor dhe e raporton atë në sistemin ALFIS.”.

Neni 2

Në nenin 17 pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Sipërfaqe të caktuara dhe toka të fondit kullor mund të jepen në përdorim për të zhvilluar në to veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme mbështetur në kërkesat si më poshtë:

- a) për lejin e veprimtarive shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike kërkohet që këto veprimtari:
 - i. të jenë të parashikuara në planin e mbarështimit të kullotës apo livadhit, ose kur nuk bie në kundërshtim me synimet e kërkesat e këtij plani;
 - ii. të mos dëmtojnë mjedisin rrethues dhe të mos sjellin pasoja të vazhdueshme negative mbi të;
 - iii. subjekti zhvillues të realizojë në vijimësi dhe përfundimisht rehabilitimin e sipërfaqes së marrë në përdorim, në përputhje me planin e rehabilitimit të hartuar prej tij e të miratuar nga struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki.
- b) për lejin e ushtrimit të veprimtarive që lidhen me prodhimin e energjisë së rinovueshme në fondin kullor shtetëror ngarkohen njësitë e qeverisjes vendore për ndjekjen e procedurave ligjore përkatëse për dhënien e së drejtës së përdorimit.”.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miratuar në datën 31.10.2024.